



Përtej ndalimit, drejt rregullimit të TikTok



POLICY BRIEF

AKADEMIAE
STUDIMEVE
POLITIKE

ASP

www.asp.al

Janar 2025

*Analizë e rreziqeve të TikTok
për të rinjtë në Shqipëri
dhe rekomandime për të rritur
sigurinë në platformat sociale*

Autor: Erjon Tase

Konsulent: Suad Barbullushi



Akademia e Studimeve Politike është anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar kundër Urrejtjes Kibernetike (INACH) dhe pjesë e programit të Komunitetit të Partnerëve të TikTok. Në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (AKSK) dhe Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), ASP mbështet prej vitit 2023 Rrjetin e Sinjalizuesve të Besuar Shqiptarë për monitorimin e materialeve të dëmshme në rrjetet sociale dhe raportuar ato në mënyrë të privilegjuar pranë platformave sociale.

Shënim

Ky dokument u mbështet mbi të dhënat e monitorimit të rrjeteve sociale nga Rrjeti i Sinjalizuesve të Besuar. Një grup prej 15 sinjalizuesish të trajnuar nga ASP, AKSK dhe QKEDH mbi identifikimin e gjuhës së urrejtjes, ekstremizmit të dhunshëm dhe propagandës ekstremiste, monitorojnë prej vitit 2023 platformat sociale të Facebook, Instagram, TikTok me qëllim raportimin e përmbajtjes të dëmshme tek ofruesit e këtyre platformave. Sinjalizuesit kanë listuar në një databazë të gjitha përmbajtjet kërcënuese që janë identifikuar, mbi të cilat më pas është bërë analiza e informacioneve.

Hyrje

Në 6 janar 2025 Ministria e Arsimit dhe Sportit prezantoi¹ Planin e Ri të Veprimit për Sigurinë në Shkollë, duke zyrtarizuar më tej njoftimin për bllokimin e platformës TikTok për rreth një vit në territorin shqiptar. Kjo masë shtrënguese u argumentua si vullnet i shprehur gjatë konsultimit me 65 mijë prindër në të gjithë shkollat e vendit, nën argumentin e një mase kundër dhunës, bullizmit, dhe kërcënimeve digjitale të nxënësve.

Kjo vendimmarrje nuk është shoqëruar deri më tani me transparencën e nevojshme të konsultimit dhe pyetjeve të shtruara për diskutim dhe e kufizuar vetëm tek një grup i shoqërisë duke mos përfshirë bizneset apo krijuesit e pavarur që shfrytëzojnë platformën dhe preken prej këtyre masave shtrënguese.

Ndalimi i plotë i aksesit në TikTok ka ngritur gjithashtu pikëpyetje për mundësitë teknologjike për

një masë të tillë si dhe efikasitetin për të frenuar nxitjen e dhunës tek të rinjtë, kur të njëjtat rreziqe do të vijojnë në platforma të tjera të ngjashme.

Shembujt e ndalimeve të deritanishme të mediave sociale në vende të tjera nuk kanë arritur qëllimet e tyre të synuara. Eksperienca e kufizimeve² të moshës në Australi ka dëshmuar se në vend që të zbusin rreziqet, bllokimet i bëjnë platformat dhe praktikrat e përdoruesve më pak të rregulluara nga institucionet. Përdoruesit i anashkalojnë kontrollet, mbikëqyrja është e fragmentuar dhe transparenca ia lë vendin paqartësisë.

Pavarësisht këtyre paqartësive për bllokimin e shërbimit, është evidente se TikTok, ashtu si të gjitha platformat e tjera të mediave sociale funksionojnë në Shqipëri pa masat e duhura rregullatore dhe transparençë për shërbimet e tyre.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

ASP AKADEMIAE
STUDIMEVE
POLITIKE

ALBANIAN NETWORK OF
Trusted Flaggers

- 1 Prezantohet Plani i Ri i Veprimit për fuqizimin e mekanizmave të sigurisë në shkollë <https://arsimi.gov.al/do-te-bllokohet-tiktok-manastirliu-plan-i-ri-veprimi-per-fuqizimin-e-mekanimzave-te-sigurise-ne-shkollë/>
- 2 Reagimi i ekspertëve për kufizimet e mediave sociale në Australi, 29 nëntor 2024 - <https://www.scimex.org/newsfeed/expert-reaction-australias-social-media-ban-passes-the-senate>

TikTok një shqetësim global

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

Rritja e shpejtë e aplikacionit TikTok është e paprecedentë në historinë e internetit. Brenda pak vitesh, ai u ngrit nga një aplikacion i veçantë për fëmijë që bënte sinkronizimin e buzëve në një nga platformat kryesore të mediave sociale në botë, të cilit përdoruesit i drejtohen gjithnjë e më shumë për t'u informuar.

Kompania kineze ByteDance e lançoi në tregun global TikTok në vitin 2018, i cili është modeluar sipas aplikacionit të tij kinez Douyin. Në shtator 2021, platforma njoftoi se kishte arritur një miliard përdorues aktivë mujorë, një moment historik që Facebook-ut iu deshën mbi tetë vjet për ta arritur. Parashikohet që platforma të rritet në 2,14 miliardë përdorues deri në fund të vitit 2025.


Çelësi i suksesit të aplikacionit është faja «Për ty» e TikTok, një rrjedhë e individualizuar videosh që duket ndryshe për çdo përdorues. Fillon automatikisht sapo hapet aplikacioni dhe analizon gjithçka që tërheq vëmendjen e përdoruesve, si p.sh. sa kohë ata shikojnë një klip përpara se të kalojnë te tjetri. Kështu, me kalimin e kohës, algoritmi mëson gjithnjë e më shumë rreth përdoruesit dhe i përshtat videot që ata shohin me interesat e tyre.

Ekzistojnë realisht disa shqetësime në lidhje me algoritmet e TikTok, të cilat kanë ngritur dyshime për qeveritë e ndryshme dhe ekspertët e sigurisë kibernetike. Këtu janë disa nga çështjet kryesore:

- 1 Privatësia e të dhënave:** TikTok mbledh një sasi të madhe të të dhënave të përdoruesit, duke përfshirë vendndodhjen, moshën, gjininë, informacionet e pajisjes dhe madje edhe të dhënat e fytyrës dhe zërit. Ky grumbullim i gjerë i të dhënave ngre shqetësime se si përdoren të dhënat dhe rrezikut për mbikqyrje.
- 2 Censura e përmbajtjes:** Algoritmi i TikTok është akuzuar për censurim të përmbajtjes, veçanërisht përmbajtjes që është kritike për qeverinë kineze. Kjo ka çuar në shqetësime rreth lirisë së shprehjes dhe potencialit për moderim të njëanshëm të përmbajtjes.

- 3 **Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dëmshme:** Algoritmi ndonjëherë mund t'i ekspozojë përdoruesit, veçanërisht ata më të rinj, ndaj përmbajtjeve të dëmshme, të tilla si video që promovojnë çrregullime të të ngrënit ose sfida të rrezikshme. Kjo ngre shqetësime për ndikimin e shëndetit mendor te përdoruesit.
- 4 **Varësia:** Algoritmi i TikTok-ut krijon vartësi për shkak të modelimit parashikues: Zbulon modelet e angazhimit dhe rregullon përmbajtjen në kohë reale. Përdor mësim përforcues për të optimizuar shfaqjen e përmbajtjeve. Afërsia për të ndikuar në sjelljen e përdoruesve ka ngritur shqetësime për varësinë dhe efektet negative në shëndetin mendor.
- 5 **Siguria Kombëtare:** Ka shqetësime se qeveria kineze mund të aksesojë të dhënat e përdoruesve përmes algoritmeve të TikTok, duke paraqitur një kërcënim për sigurinë kombëtare. Kjo ka çuar në debate nëse aplikacioni duhet të ndalohet apo kufizohet në vende të caktuara.

Këto shqetësime kanë nxitur kufizimin e TikTok në 20 shtete të ndryshme deri më sot³.



Legend:
 □ TikTok available on all devices
 ■ TikTok banned on national governmental devices
 ■ TikTok previously banned for all users
 ■ TikTok discontinued for download
 ■ TikTok banned for all users *de jure*, but not enforced
 ■ TikTok banned for all users *de facto*
 ■ TikTok banned for all users
 ■ TikTok unavailable; Douyin used instead
 ■ Not shown: Banned on EU and NATO devices

Burimi: Wikipedia – Vendet ku është censuruar TikTok

3 Lista e vendeve ku është ndaluar apo kufizuar TikTok mund të konsultohet në Shtojcën 1

Rreziku për fëmijët dhe të rinjtë

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

Raportet e deritanishme ndërkombëtare që kanë tentuar të hedhin më shumë dritë mbi përdorimin e TikTok nga të rinjtë, ngrenë shqetësimin për efekte të thella psikologjike që mund të shkaktohen nga përdorimi i kësaj platforme sociale.

Një studim⁴ i Amnesty International i publikuar në nëntor 2023 shkaktoi shumë diskutime duke konkluduar se sistemi i rekomandimit të përmbajtjes së TikTok dhe “praktikat e tij invazive të mbledhjes së të dhënave” përfaqësojnë “një rrezik për përdoruesit në moshë të re, pasi përforcon përmbajtjen depresive dhe vetëvrasëse që rrezikon të përkeqësojë problemet ekzistuese të shëndetit mendor”. Ekspertët nënvizuan në këtë studim se arsyeja kryesore e këtyre problemeve duhet parë tek praktikat agresive të biznesit të TikTok për të rritur audiencën dhe të ardhurat nga reklamimet.

Disa investigime të bëra publike në muajin tetor 2024 zbuluan se si çështja e adoleshentëve në këtë platformë ishte një çështje e njohur për TikTok, por ajo nuk bëri asgjë për të frenuar problemin.

Komisioni Evropian nisi gjithashtu një hetim⁵ shkurtin e kaluar ndaj TikTok për dështimin e mundshëm të mbrojtjes së fëmijëve dhe privatësisë së përdoruesve sipas rregullores së Aktit të Shërbimeve Dixhitale (DSA). Hetimi vijon ende dhe në rast të zbulimit të shkeljeve kompania rrezikon të gjobitet deri në 6 përqind të të ardhurave vjetore në rang botëror.

Nën këtë trysni, TikTok ka njoftuar së fundi më shumë se 2 miliardë USD investime për të forcuar sigurinë e 175 milionë përdoruesve mujorë në Evropë si dhe ka përditësuar politikën për verifikimin e moshës dhe disa ndryshime në efektet që duhet të ndihmojnë në shmangien e një ndikimi të tepruar në psikikën e të rinjve.

Këto masa janë të kushtëzuara edhe nga hyrja në fuqi në shkurt 2024 e Aktit të Shërbimeve Digjitale⁶, si një kornizë rregullatore për platformat e rrjeteve sociale që veprojnë në territorin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtij Akti, TikTok dhe platformat e tjera të mëdha janë të ngarkuara me përgjegjësi për përmbajtjet që ofrojnë dhe duhet të ofrojnë transparencë mbi shërbimet e tyre.

4 Të orientuar në errësirë: Si rekomandimi ‘Për ty’ i TikTok inkurajon vetëdëmtimin dhe idetë vetëvrasëse - <https://www.amnesty.org/en/documents/POL40/7350/2023/en/>

5 Komisioni Evropian nis hetimin ndaj TikTok: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_24_926

6 Akti për Shërbimet Digjitale (DSA) - https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/europe-fit-digital-age/digital-services-act_en

TikTok dhe Shqipëria

Nuk raportohet shifra zyrtare për përdoruesit e TikTok në Shqipëri, por duke krahasuar numrat e mësipërm në nivel global, mund të kuptohet lehtësisht se Shqipëria përbën një treg të papërfillshëm për kompaninë gjigande kineze.

Duke mos qënë ende anëtar i Bashkimit Evropian, vendi ynë nuk mund të përfitojë nga mbrojtja që ofron rregullorja e DSA, por edhe përbashkët ligjore dhe financiare në rast shkeljesh nga TikTok dhe platformat e tjera gjigande.

Dokumenti⁷ i Planit të Rritjes 2024-2027 për Shqipërinë përcakton si një objektivi nisjen e një analize të hendekut ligjor mes legjislacionin kombëtar dhe DSA me synimin e transpozimit të plotë të kësaj kornize deri në qershor 2026.

Në të njëjtën kohë, qeveria shqiptare ka vendosur prej vitit 2023 kontakte direkte me TikTok duke mundësuar kanalet e privileguara të raportimit të materialeve të dëmshme nëpërmjet Policisë së Shtetit dhe Autoritetit të Mediave Auditive (AMA). Gjatë muajve të fundit, TikTok është zotuar që të punësojë monitorues që njohin gjuhën shqipe si dhe ka krijuar

kanale të privileguara për organizatat me ekspertizë për raportimin e materialeve të dëmshme si Isigurt.al (CRCA) dhe Rrjeti i Sinjalizuesve të Besuar.

Në rast se Shqipëria do të pezullojë shërbimin e TikTok në muajt e ardhshëm rrezikohet që të humbasin këto kanale zyrtare komunikimi për të nisur hetime penale apo edhe bllokuar materialet e dëmshme të konstatuara në gjuhën shqipe për përdoruesit që do të vijojnë të aksesojnë në forma të tjera këtë rrjet.

Të gjitha këto përpjekje zyrtare për të bashkëvepruar me TikTok nuk kanë arritur të përmirësojnë situatën gjatë vitit 2024. Monitorimi nga Rrjeti i Sinjalizuesve të Besuar (Trusted Flaggers) mbi gjuhën e urrejtjes dhe propagandës ekstremiste që qarkullon në gjuhën shqipe në platformat sociale, konfirmon shqetësimet e prindërve dhe mësuesve për platformën TikTok.

Analiza e rrjeteve sociale identifikon për të dytin vit rradhazi "TikTok" si platformën me më shumë ekspozim të gjuhës së urrejtjes, përmbajtjes së dhunshme dhe sjelljeve me natyrë seksiste.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H


ASP AKADEMIJA E STUDIMEVE POLITIKE

ALBANIAN NETWORK OF
Trusted Flaggers

7 Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027
- <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Dokument-Politik-Agenda-Kombetare-e-Reformave-2024-2027.pdf>

Grafiku më poshtë pasqyron të dhënat e monitorimit nga Rrejtja e

Sinjalizuesve të Besuar gjatë vitit 2024:



Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të TikTok

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

Analiza e materialeve të konstatuara ngre shqetësimin se platforma TikTok ka një diferencë të theksuar në përmbajtjen e gjuhës vulgare, gjuhës së urrejtjes dhe bullizmit, e përdorur nga të rinjtë, të cilët janë edhe përdoruesit më të shumtë të saj.

Analizimi konstaton mungesën e përdorimit të TikTok të filtrave të duhur apo inteligjencës kompjuterike të dedikuara në gjuhën shqipe. Kompania Meta ka krijuar tashmë filtra të tillë që parandalojnë postimin e fjalëve apo hashtagëve të caktuar në shqip të lidhur me bullizmin, diskriminimin racor e gjinor apo edhe krimet e dhunshme.

Një tjetër problematikë që e vështirëson moderimin e kësaj përmbajtje në TikTok është kontenti kryesor në format video. Moderimi kompjuterik dhe ai njerëzor është më i vështirë në

rast të gjuhës së folur përkundër asaj të shkruar.

Dhuratat (gifts) apo format e tjera të shpërblimit mes përdoruesve të platformës nxisin gjithashtu diskutime agresive në dhomat e bisedave live apo publikimin e pamjeve të dhunshme që tërheqin më shumë audiencë dhe përkthehen në përfitime monetare.

Nevojitet të theksohet se TikTok nuk është e vetmja platformë ku ndeshen përmbajtje të dhunshme dhe gjuhë urrejtjeje, duke dëshmuar se kjo situatë më rrjetet sociale pasqyron kulturën e dhunshme dhe çështje më të gjera në shoqërinë shqiptare.

Rekomandime

Sistemet algoritmike të TikTok dhe platformave të tjera sociale tashmë mbizotërojnë hapësirat tona publike digjitale. Rrjetet sociale janë kanalet kryesore të komunikimit dhe informimit si dhe shprehjes së mendimeve dhe pjesëmarrjes qytetare. Në këtë kuptim është thelbësore që të forcohet rregullimi i këtyre platformave të fuqishme duke mos kufizuar lirinë individuale të shprehjes të përdoruesve të tyre.

Krahasuar me ndalimin e TikTok dhe platformave të tjera, rregullimet ligjore të shërbimeve që ofrohen nga këto rrjete mbeten një zgjidhje më afatgjatë dhe në respekt të të drejtave themelore të qytetarëve.

Qeveritë dhe institucionet rregullatore ndërkombëtare, mes

tyre dhe Shqipëria, janë fokusuar deri më sot në identifikimin dhe kërkesën ndaj platformave për të hequr përmbajtjen e paligjshme ose tentuar kufizimin e shërbimeve të tyre. Megjithatë, këto përpjekje mbeten të pafuqishme për të kontrolluar dhe bllokuar sasinë e pafundme të përmbajtjes së dëmshme që krijohet nga miliardat përdorues si dhe vullnetin e zotëruesve të platformave për të rritur audiencat dhe fitimet e tyre.

Për këtë arsye, rekomandimi kryesor mbetet hartimi i masave ligjore dhe mekanizmave që rregullojnë funksionimin e platformave të rrjeteve sociale, duke i ngarkuar ato me detyrime për rritjen e transparencës dhe zbatimin e masave për të kontrolluar përmbajtjen që qarkullon në shërbimet e ofruara prej tyre.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H



Rekomandime për autoritetet shqiptare

Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, më poshtë renditen disa nga masat që mund të

kërkohen nga autoritetet shqiptare për rregullimin e operimit të TikTok në Shqipëri:

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

- **Rritja e transparencës:** Bazuar mbi praktikën e DSA, platforma duhet të ofrojë për autoritetet rregullatore shqiptare transparencë për përmbajtjen, algoritmet e saj si dhe masat e marra për materialet e raportuara nga përdoruesit shqiptarë. Raportet vjetore të detajuara për çdo vend anëtar janë një praktikë që kërkohet që prej vitit 2023 nga Bashkimi Evropian.
- **Auditime të rregullta:** Institucionet rregullatore dhe studiuesit e pavarur duhet të kenë akses për të kryer vlerësime të algoritmeve të sugjerimeve për përmbajtjen si dhe praktikave të moderimit të për t'u siguruar që ato janë efektive dhe të përditësuara me kërcënimet dhe tendencat më të fundit.
- **Verifikimi i përmirësuar i moshës:** Zbatimi i metodave më të rrepta të verifikimit të moshës për të siguruar që vetëm përdoruesit mbi një moshë të caktuar mund të hyjnë në platformë. Rekomandohet të rritet më tej limiti i moshës 13 vjeç për përdoruesit.
- **Kontrollet prindërore:** Forcimi i kontrolleve prindërore për t'i lejuar prindërit të monitorojnë dhe kufizojnë përdorimin e aplikacionit nga fëmijët e tyre. Kjo mund të përfshijë vendosjen e kufijve kohorë, kufizimin e llojeve të caktuara të përmbajtjes dhe marrjen e raporteve të aktivitetit.
- **Moderimi i përmirësuar i përmbajtjes:** Rritja e numrit të moderatorëve njerëzorë në gjuhën shqipe dhe përmirësimi i sistemeve të automatizuara të moderimit në shqip (filtrave) për të zbuluar dhe hequr përmbajtjen e dëmshme në mënyrë më efektive.
- **Raportimi prioritar:** Ofrimi i edukimit për përdoruesit dhe sinjalizues me ekspertizë në gjuhën shqipe dhe nxitja e kanaleve të privileguara për të bashkëpunuar në identifikimin dhe bllokimin e materialeve të dëmshme dhe dezinformimit në këtë rrjet.

Këto rekomandime është e nevojshme që të mos kufizohen vetëm tek TikTok, por në të gjitha plat-

format e tjera sociale me përdorim të gjerë në Shqipëri.

Rekomandime të mëtejshme për edukimin

Përtej masave rregullatore për platformat është e nevojshme një trajtim shumëplanësh i proble-

meve shoqërore që nxisin dhunën dhe urrejtjen e të rinjve në rrjetet sociale:

Zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit:

Zbatimi i programeve të edukimit gjithëpërfshirëse, që synojnë të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e narrativës së gjuhës së urrejtjes dhe dhunës. Këto programe duhet të fokusohen në aftësitë e të menduarit kritik, edukimin mediatik dhe qytetarinë digjitale.

Promovimi i hapësirave pozitive në internet:

Inkurajimi i krijimit të hapësirave pozitive në internet që promovojnë tolerancën, diversitetin dhe përfshirjen. Kundërshtimi i narrativave ekstremiste përmes fushatave të mediave sociale, forumeve në internet dhe historive pozitive.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

Shtojca 1

Kufizimet e TikTok nga vende të ndryshme

Mbi 20 shtete kanë zbatuar ndalime të pjesshme ose të plota në TikTok për shkak të shqetësimeve mbi privatësinë e të dhënave, sig-

urinë kibernetike dhe ndikimin e mundshëm të huaj. Këtu është një përmbledhje:

Ndalime të plota

Indi: Në vitin 2020, pas tensioneve kufitare me Kinën, India vendosi një ndalim të pacaktuar për TikTok, duke përmendur shqetësimet e sigurisë kombëtare.

Afganistan: Në prill 2022, qeveria talebane ndaloi TikTok, duke shprehur shqetësime për ndikimin e tij tek të rinjtë.

Somali: Në gusht 2023, qeveria e Somalisë ndaloi zyrtarisht TikTok, Telegram dhe 1XBet, duke përmendur përhapjen e propagandës dhe përmbajtjes së pahijshme.

Nepal: Në nëntor 2023, Nepali njoftoi një ndalim të TikTok, duke përmendur shqetësimet për prishjen e harmonisë sociale nga keqpërdorimi i aplikacionit.

Iran: Qasja në TikTok është e kufizuar në Iran për shkak të politikave të platformës dhe rregulloreve kombëtare të censurës.

Siri: TikTok është i ndaluar në Siri, megjithëse detajet specifike rreth ndalimit janë të kufizuara.

Jordani: Në dhjetor 2022, Jordania vendosi një ndalim të përkohshëm për TikTok pas vdekjes së një oficeri policie gjatë protestave. Statusi i ndalimit ka luhatur, me raporte që tregojnë se është hequr dhe më pas ndoshta është rivendosur.

Kirgistan: Në gusht 2023, autoritetet Kirgistan ndaluan TikTok, duke përmendur shqetësimet për efektet e tij në zhvillimin e fëmijëve. Ndalimi u hoq disa ditë më vonë.

Uzbekistan: TikTok është i ndaluar në Uzbekistan, megjithëse detajet specifike rreth ndalimit janë të kufizuara.

Shtetet e Bashkuara: Më 19 janar 2025, SHBA miratoi një ndalim mbarëkombëtar për TikTok, duke çuar në mbylljen e aplikacionit brenda vendit.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të TikTok

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

Ndalimet dhe kufizimet e pjesshme

Bashkimi Evropian: Në shkurt 2023, Komisioni Evropian dhe Këshilli Evropian ndaluan TikTok nga pajisjet zyrtare, duke përmendur shqetësimet e sigurisë kibernetike.

Francë: Në mars 2023, Franca ndaloi përdorimin e TikTok dhe aplikacioneve të tjera rekreative në pajisjet e punonjësve të qeverisë për shkak të shqetësimeve të sigurisë së të dhënave.

Mbretëria e Bashkuar: Në mars 2023, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ndaloi TikTok në pajisjet zyrtare të përdorura nga ministrat dhe nëpunësit civilë, duke përmendur shqetësimet e sigurisë.

Belgjikë: Në mars 2023, Belgjika ndaloi TikTok nga pajisjet e punës së qeverisë federale për shkak të shqetësimeve të sigurisë kibernetike, privatësisë dhe dezinformimit.

Danimarkë: Në mars 2023, Ministria e Mbrojtjes e Danimarkës ndaloi TikTok në pajisjet e punës, duke u përafuar me shqetësimet më të gjera evropiane në lidhje me sigurinë e të dhënave.

Norvegji: Në mars 2023, Norvegjia këshilloi kundër instalimit të TikTok në pajisjet me akses në sistemin e saj parlamentar, duke reflektuar shqetësime mbi privatësinë e të dhënave dhe shkeljet e mundshme të sigurisë.

Holandë: Në mars 2023, qeveria holandeze rekomandoi që nëpunësit civilë të shmangin përdorimin e TikTok, në pritje të një rishikimi të praktikave të privatësisë së të dhënave të aplikacionit.

Zelanda e Re: Në mars 2023, Zelanda e Re ndaloi TikTok në pajisjet e lidhura me rrjetin e saj parlamentar, duke përmendur shqetësimet e sigurisë kibernetike.

Australi: Në prill 2023, Australia ndaloi TikTok në pajisjet qeveritare, duke përmendur shqetësimet e sigurisë.

Kanada: Në nëntor 2024, Kanadaja urdhëroi TikTok të mbyllte zyrat dhe kompaninë e saj filial në vend për shkak të shqetësimeve të sigurisë kombëtare, por qasja në aplikacion nuk u ndalua.

Përtej ndalimit,
drejt rregullimit
të **TikTok**

P Ë R M B L E D H J E P O L I T I K A S H

ASP AKADEMIAE
STUDIMEVE
POLITIKE

ALBANIAN NETWORK OF
Trusted Flaggers